



01/Nr. 2967 /2024
Data: 19.04.2024

PROCESVERBAL I KOMITETIT PER KOMUNITET

Nga mbledhja e dytë -III-për vitin 2024 i Komitetit për Komunitete, mbajtur me datë: 27.03.2024 me fillim pune në ora 14:00 në sallën e takimeve. Kryesuesi konstatoi se nuk mungon asnjë anëtarë i Komitetit për Komunitete. I pranishëm ishte z.**Abdurrahman Bushi** (Drejtori Bujqësisë Pylltari dhe Zhvillim Rural).

RENDI I PUNËS

- 1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
- 2.Takim me Drejtorine për Zhvillim Ekonomik
- 3.Takim me Drejtorine përBujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural
- 4.Eventuale

Kryesuesi thekson:- për pikat e rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin; nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. Takim me Drejtorine për Zhvillim Ekonomik

Kryesuesi thekson: kalojmë në pikën tjetër të rendit të punës pasi që nuk është prezent Drejtorja e Zhvillimit Ekonomik

Zaim Bela thekson: Pasi që nuk është drejtoresha në takim un kam propozuar që nëse një drejtor nuk është prezent në takim atëherë në mbledhjen e ardhshme të muajit prill të futet si pike ftesa për drejtorin.

3. Takim me Drejtorinë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Zaim Bela thekson: un kisha pyetje rreth serrave pasi që është fundi i muajt mars pse nuk janë vendosur ende najllonet e serrave.

Abdurrahman Bushi thekson: Montimi i serrave është bërë në sezonin e dimrit një prej kriterëve ishte temperaturat nëse temperaturat janë 20 gradë nëse folia vendoset nën 20 gradë atëherë nuk kishte mundësi me u tërheq me u vendos mire e kur temperaturat shkojnë më lart ajo lirohet e në rast se ka erëra mundet që najlloni të priset, si të fillojnë me u ngritë temperaturat do të vendosen najlloni.

Kryesuesi thekson: Pse komuna nuk merr iniciative për shartimin e pemëve.

Abdurrahman Bushi thekson: Ne me se shumti punojmë sipas kërkesave , nuk kemi pas kërkesa rreth shartimit të pemëve .

Kryesuesi thekson: Cila bimë rritet në vendin tonë ?

Abdurrahman Bushi thekson: Si tok e rrit çdo sen ajo që dallon në shtrirjen gjeografike të kulturës bujqësore është klima , toka e benë çdo sen po për shkak të klimës thahen.

Resul Suma thekson: Kur bëhet hapja për thirrje te LAB dhe a është e specifikuar çfarë kërkohet kësaj here. Pyetja tjetër është rreth pishave në fshatin Seçisht a janë dëmtuar nga bagëtit.

Abdurrahman Bushi thekson : Sa i përket LAB-it un kam pas një takim , LAB-i e ka një program me katër linje ka pas tre linje tash është shtuar edhe linja për shërbime publike dhe ambientale un kam biseduar me ta rreth bletëve gjithashtu rrallimin e pyjeve publike kam kërkuar të bashkëngjitet edhe LAB-i me shumën e caktuar që është pesë mijë euro mirëpo programi i LAB-it duhet të miratohet nga bordi i Sharrcemit . Ndërsa tek pishat nuk janë zhvilluar disa po disa janë mire.

eventuale

Anëtarët e Komitetit për Komunitete diskutuan rreth dukurive negative në Komunën e Hanit të Elezit përdorimi i narkotikeve si dhe parandalimi i tyre po ashtu ata rekomanduan programe rreth parandalimit të dukurive negative

Mbledhja përfundoi në ora 14:45

Procesmbajtësja
Sara Berisha

